



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION




Emri i Biznesit: "Radio Plus" SH.P.K.
NUI: 810530528
Pronari: Mixhait REÇI
OSHMA: Radio PLUS
Adresa: Rr/Gazmend Zajmi, Nr.44, Prishtinë

Emri i Biznesit: "Radio Plus" SH.P.K.
NUI: 810530528
Kandidati për pronar: Ilber BEQIRI
OSHMA: Radio PLUS
Adresa: Rr/Gazmend Zajmi, Nr.44, Prishtinë

VENDIM

për ndryshimin e pronësisë, respektivisht ndryshimin e pronarit si person fizik të Radio Plus
me seli në Komunën e Prishtinës



Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.
2. Radio Plus është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio me mbulim regjional, i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetimin tokësorë të programeve të radios, me seli në Prishtinë. KPM, me vendimin e datës 2 nëntor 2016, ka bërë ripërtëritjen e licencës së Radio Plus për një afat prej shtatë (7) vitesh.
3. Më datën 4 tetor 2021, Radio Plus ka dorëzuar në zyrën e KPM-së një kërkesë përmes së cilës ka kërkuar miratim për ndryshimin e pronësisë, respektivisht ndryshimin e pronarit si person fizik dhe bartjen e licences së Radio Plus nga z. Mixhait Reçi, tek z. Ilber Beqiri në kuadër të biznesit të njëjtë në të cilin është lëshuar licenca e Radio Plus - "Radio Plus" SH.P.K. me Numër Unik Identifikues (NUI) 810530528.

Arsyetim

4. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: "*licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së*".
5. Neni 15. pika 2. Paragrafi 1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: "*Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së*".
6. Neni 15.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: "*KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur sigurohet që personi fizik apo*

juridik, për të cilin propozimet që i i transferon licencën, i plotëson standardet e kësaj lloji për të iu dhënë një licencë.”

7. Komisioni konstaton se, kandidati i propozuar për pronar të ri të Radio Plus (kandidati), përmes një deklarate me shkrim, ka shprehur gatishmëri që ofrimin e shërbimeve mediale audio për publikun ta bëjë në pajtueshmëri me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
8. Komisioni konstaton se kandidati ka një përvojë të gjatë të punës në radio, pasi që i njëjti është pjesë e kësaj radioje prej 21 vitesh, ndërsa aktualisht është në pozitën e kryeredaktorit të radios.
9. Komisioni konstaton se, kandidati përmes një plani të biznesit lidhur me të hyrat, shpenzimet dhe profitin, ka paraparë investime në teknologjinë e transmetimit të Radio Plus, angazhimin e stafit profesional, ndërsa sa i përket qëndrueshmërisë financiare, kandidati për pronar të radios, ka bashkangjitur edhe dëshmi nga institucionet financiare.
10. Komisioni konstaton se, paraprakisht Radio Plus ka shlyer të gjitha obligimet financiare ndaj KPM-së.
11. Duke u bazuar në gatishmërinë e shprehur të kandidatit për pronar të ri të radios për të punuar në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së, zotimet për angazhimin e stafit profesional, përvojën e gjatë të punës në radio të kandidatit, dëshmitë rreth qëndrueshmërisë financiare, Komisioni vlerëson se ndryshimi i pronësisë së Radio Plus është në interes të publikut.
12. Komisioni vlerëson se, kërkesa është bërë në pajtim me procedurat e KPM-së, të bazuara në Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë i plotëson kriteret për miratim.

Vendim

13. Komisioni në takimin e tij të mbajtur më datën 16 nëntor 2021, merr vendim për miratimin e kërkesës për ndryshimin e pronësisë, respektivisht ndryshimin e pronarit si person fizik dhe bartjen e licencës së Radio Plus nga z. Mixhait REÇI, tek z. Ilber BEQIRI në kuadër të biznesit të njëjtë, në të cilin është lëshuar licenca e Radio Plus - “Radio Plus” SH.P.K., me Numër Unik Identifikues (NUI) 810530528.
14. Përveç ndryshimit të pronësisë dhe bartjes së licencës të Radio Plus nuk do të ketë ndryshime në pjesët tjera të Licencës, si Pjesës II – Parametrave Teknik, III – Formatit të Programit dhe IV – Zonës së Mbulimit.
15. Me anë të këtij vendimi të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Radio Plus barten te pronari i ri.
16. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.

Xhevat LATIFI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



22.11.2021

datë